

Risku i këmbimit valutor, ekspozimet
ndaj tij dhe drejtimi i tyre

Përmbajtja e ligjëratës

- Përcaktimi i riskut të monedhës së huaj dhe ekspozimit ndaj tij
- Ekspozimi nga transaksioni në monedhë të huaj
- Identifikimi i ekspozimit në momentin që inicohet transaksioni
- Drejtimi i ekspozimit nga transaksioni në monedhë të huaj
- Evidentimi në rezultatin financiar dhe vlerën e mbartur
- Pozicioni i monedhës së huaj

Përcaktimi i riskut

- Risku i këmbimit (i monedhës së huaj) ka të bëjë me pasigurinë në evolucionin e kursit të këmbimit.
- Është fitimi ose humbja e mundshme e cila mund të rezultojë nga ndikimi i ndryshimit të kurseve të këmbimit.
- Është një koncept subjektiv dhe ka lidhje me lëvizjet që përballohen ose që priten të përballohen në të ardhmen.
- Pasiguria është dhe do të mbetet shkaku i riskut i cili nga ana e vet krijon hapësira për veprime që mund të sjellin edhe fitime apo humbje të mundshme.
- Problemet e riskut të monedhës mund të analizohen mbështetur në ndikimin e tyre mbi ekonominë kombëtare dhe mbi ndërmarrjen

Risku i monedhës në ekonominë kombëtare

- Në ekonominë kombëtare vlera e monedhës kombëtare kërcënon ekuilibrat kryesor.
- Lufatja e tyre provokon kriza monetare në vend dhe më pas në arenën ndërkombëtare.
- Duhet mbahen parasysh dy gjëra kryesore:

Risku i monedhës në ekonominë kombëtare

- 1) Parashikimi dhe kontrolli i monedhës kombëtare është përcaktues në marrëdhënjet e këmbimit me jashtë. Kur monedha vendase zhvlerësohet (ngritje e kursit të këmbimit) qmimet e produkteve të importuara rriten, ndërsa qmimet e produkteve të eksportuara ulen. Për pasojë, rreziku i këmbimit ndikon në bilancin tregtar.
- 2) Ndryshimet e KK ndikojnë direkt në lëvizjen afatshkurtër të kapitaleve. Integrimi financiar ndërkombëtar konkretizohet me euro-tregjet. Për më tepër, ai i dha një zhvillim rritjes ekonomike të zhvilluara të Evropës dhe SHBA. Nga ana tjetër, ekzistenca e këtij potenciali, të financimit konsolidoi ekuilibrat më të rëndësishëm.